

VENDIM
Nr. 592, datë 29.8.2012

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË SIPËRFAQES 2661 M², TRUALL,
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8160, PJESE E PASURISË 7/2 DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMET NR. 834, DATË 13.12.2006 DHE NR. 1058, DATË 16.7.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 shkronja “k”, 5, e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të sipërfaqes 2661 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) m², truall, ndodhur në zonën kadastrale 8160, pjesë e pasurisë 7/2, sipas formularit 1 dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për interesa vendorë.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Bashkisë Tiranë, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqet nga prona me numër rendor 5, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha